

THIRRJE PËR APLIKIM : Kurs *Online mbi Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje*

Këshilli i Evropës dhe Akademia e Drejtësisë e Kosovës kanë kënaqësinë të bashkëpunojnë me Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës dhe të ofrojnë këtë mundësi trajnimi për Studentët e Drejtësisë, duke synuar të rrisin më tej njohuritë e tyre mbi temat kryesore të të drejtave të njeriut siç janë parandalimi dhe luftimi i dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, dhe kështu të kontribuojë në një mbrojtje më të mirë të të drejtave të njeriut dhe të drejtave të grave në nivel lokal.

Kursi **HELP Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje** mbulon në një mënyrë interaktive konceptet kryesore, kornizën ligjore ndërkombëtare dhe Evropiane dhe praktikën gjyqësore që rregullon parandalimin dhe mbrojtjen e grave dhe vajzave nga dhuna, duke u përqëndruar veçanërisht në Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimi i Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit). Kursi do të ofrohet në gjuhën shqipe, dhe pas përfundimit të suksesshëm studentët do të marrin certifikatë.

Kursi përbëhet nga gjashtë modulet thelbësore:

1. Kuptimi i dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
2. Kuadri Ligjor Ndërkombëtar dhe Evropian;
3. Tejkalmi i pengesave në Drejtësi;
4. Përgjigja e Drejtësisë Penale;
5. Përgjigja e Drejtësisë Civile;
6. Përmbledhje.

Ky kurs online ofrohet përmes Edukimit për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës për Profesionistët Ligjorë (HELP), e cila është platforma kryesore arsimore e Këshillit të Evropës për profesionistët ligjorë. Për më shumë informacion mbi kurset HELP, ju lutemi shihni linkun [Council of Europe HELP \(coe.int\)](https://www.coe.int)

Kush mund të aplikojë: Studentët e Drejtësisë që ndjekin vitin e katërt apo Masterin në Fakultetin e Drejtësisë - Universiteti i Prishtinës.

Dokumentet që duhet të paraqisni për aplikim: CV dhe letra motivuese (në shqip ose anglisht).

Ku t'i dërgoni aplikacionet: përmes e-mail tek vaw.pristina@coe.int

Afati i fundit për aplikim: 03 mars 2022 (tbc)

Ky kurs online po organizohet nga projekti i Këshillit të Evropës "Fuqizimin e Luftës kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje - Faza III".